REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 4433 Prot

Projekt-Vendim -Nr.6

Për "Dhënien e Ndihmës Financiare përfituesëve nga projekti "Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar" financuar nga Fondi Social"

Në kuadër të projektit "Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar" me qëllim dhënien e ndihmës financiare për mbulimin e nevojave për shërbim mjekësor për të moshuarit në nevojë, përfitues të këtij projekti financuar nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore",i ndryshuar , të nenit 8 pika 2 , nenit 9 nënpika 1.1, gërma "b", i propozojmë Këshillit të Bashkisë Maliq:

I. Miratim ndihmë financiare për shërbime mjekësore për të moshuarit si më poshtë;

Nr.	Emri Mbiemri	ID	Nj.Administrative	Shuma
1	Z.Koci Kuka	E01305169V	Maliq	25 000 lekë
2	Znj.Sanije Kanani	E85518020D	Libonik	25 000 lekë
	Totali			50 000 lekë

II. Fondi do të përballohet nga buxheti i projektit "Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar" të financuar nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

III. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashki.

(EmërMbiemër) Nënshkrimi

Konceptoi: E.Bezati
Pranoi Drejtoria e Shërbimit Social E.Petriti

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 4438 Prot

RELACION

Për "Dhënien e Ndihmës Financiare përfituesëve nga projekti "Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar" financuar nga Fondi Social"

Në kuadër të projektit "Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar" me qëllim dhënien e ndihmës financiare për mbulimin e nevojave për shërbim mjekësor për të moshuarit në nevojë, përfitues të këtij projekti financuar nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore",i ndryshuar , të nenit 8 pika 2 , nenit 9 nënpika 1.1, gërma "b", Gjatë implementimit të projektit janë identifikuar disa raste të cilat kanë nevojë për mjekime të cilat janë të kushtueshmë dhe sigurimi i tyre rendon gjendjen ekonomike te familjeve dhe individëve përfitues të këtij projekti. Dy nga rastet të cilët sipas punonjësve të shërbimit në familje janë konsideruar më emergjente janë si më poshtë:

1. Sanije Kanani

Znj. Sanije Muharem Kanani është banore e fshatit Libonik, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq. Aktualisht ajo jeton e vetme, pasi djali i saj ka ndërruar jetë si pasojë e një sëmundjeje të rëndë. Kjo ngjarje ka ndikuar ndjeshëm në gjendjen e saj emocionale, sociale dhe ekonomike, duke e lënë pa mbështetje të përditshme familjare.Nga vlerësimi i kryer rezulton se znj. Sanije është në moshë të thyer dhe, për shkak të gjendjes së saj fizike dhe moshës së avancuar, e ka të vështirë të përmbushë në mënyrë të pavarur nevojat e përditshme dhe mirëmbajtjen e banesës. Kushtet e banimit janë të amortizuara dhe nuk ofrojnë standarde të përshtatshme jetese, për këtë arsye rasti është referuar pranë programit të strehimit për shqyrtim dhe mbështetje.Shërbimi Social i Bashkisë Maliq ka ndjekur rastin në mënyrë të vazhdueshme, duke realizuar vizita periodike në banesë, vlerësimin e situatës social-ekonomike dhe identifikimin e nevojave të saj. Në kuadër të mbështetjes së ofruar, znj. Sanije ka përfituar paketa ushqimore dhe është asistuar për sigurimin e kujdesit higjieno-sanitar, sipas nevojave të konstatuara gjatë monitorimit të rastit. Gjithashtu, punonjësit socialë kanë ofruar këshillim dhe orientim për përfitimin e shërbimeve sociale dhe programeve mbështetëse që ofron Bashkia.Nga vlerësimi rezulton se znj. Sanije është një person në nevojë për mbështetje të vazhdueshme institucionale, si për përmirësimin e kushteve të banimit, ashtu edhe për përfitimin e shërbimeve sociale sipas legjislacionit në fuqi.Në përfundim, duke marrë në konsideratë moshën e avancuar, mungesën e mbështetjes familjare, gjendjen e vështirë social-ekonomike dhe nevojën për mbështetje të vazhdueshme, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026

2. Koçi Kuka

Z. Koçi Kuka është banues i qytetit Maliq, Bashkia Maliq. Familja e tij përbëhet nga dy anëtarë, z. Koçi dhe vajza e tij, znj. Rajmonda Kuka. Vajza është person me aftësi të kufizuara dhe përfiton pagesën e aftësisë së kufizuar (PAK). Së fundmi, ajo është diagnostikuar me sëmundje onkologjike (CA MAMMAE), e cila kërkon trajtim të specializuar, kontrolle periodike dhe ndjekje të vazhdueshme mjekësore. Edhe z. Koçi Kuka paraqet probleme të theksuara shëndetësore, të cilat kanë ndikuar në uljen e aftësisë së tij për të përballuar nevojat e përditshme dhe për të siguruar të ardhura të mjaftueshme për familjen.Shërbimi Social i Bashkisë Maliq ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme këtë rast, duke realizuar vizita në banesë, vlerësime të situatës social-ekonomike dhe koordinim me institucionet përkatëse për ofrimin e mbështetjes së nevojshme. Gjendja e rënduar shëndetësore e të dy anëtarëve të familjes ka sjellë rritje të ndjeshme të shpenzimeve për trajtim mjekësor, medikamente, transport dhe nevoja të tjera të domosdoshme.Nga vlerësimi social-ekonomik rezulton se familja ndodhet në kushte të vështira ekonomike, të diktuara nga gjendja e rënduar shëndetësore dhe pamundësia për të përballuar me forcat e veta shpenzimet e vazhdueshme të trajtimit dhe jetesës. Në këto kushte, i drejtohemi Këshillit Bashkiak Maliq për miratimin e një ndihme financiare, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme.

(EmërMbiemër)

Konceptoi: E.Bezati
Pranoi Drejtoria e Shërbimit Social E.Petriti

Nënshkrimi

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ